



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2826 Prot.

Tiranë, më 25.11.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 62 Datë 25.11 2025

**“PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË
STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË “FIZIOTERAPI KLINIKE DHE
REHABILITIM” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT, NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të nenit 3 pika 2, nenit 35, 49, 70, 75 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendim nr 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendim nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, nenit 7 pika 2, nenit 43, 73, 75 të Statutit të UST-së, nenit 24, 52, 53, 55 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr. 2308/1 Prot., datë 07.11.2025 "Propozim për miratimin e dokumentacionit për hapjen e Programit të Ciklit të dytë të studimit "Master Shkencor në "Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim" në FSHR", në Vendimin e Rektoratit nr.141 dt, 10.11.2025, në Vendimin e Senatit Akademik nr 155 datë 11.11.2025, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 25.11.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit të hapjes së programit të studimit Master Shkencor në "Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim" në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit" të UST-së, sipas dokumentacionit bashkëlidhur;
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

